Kur t'ju ndaloj nga diçka, largohuni prej saj, kurse atë që jua urdhëroj, bëjeni, aq sa keni mundësi

Nga Ebu Hurejra Abdurrahman ibën Sahri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se thënë: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Kur t'ju ndaloj nga diçka, largohuni prej saj, kurse atë që jua urdhëroj, bëjeni, aq sa keni mundësi, ngase ata që ishin para jush janë shkatërruar për shkak të pyetjeve të shumta dhe kundërshtimit ndaj të dërguarve të tyre."

[Sahih] [رواه البخاري ومسلم]

I Dërguari i Allahut ﷺ na ka sqaruar se kur na ndalon nga diçka, është detyrë për ne ta shmangim atë pa përjashtim, sikundër që, kur na urdhëron për diçka, duhet ta bëjmë atë sipas mundësisë. Pastaj na paralajmëroi që të mos bëhemi si disa nga popujt e mëparshëm, të cilët i shtronin shumë pyetje të dërguarve të tyre, duke i kundërshtuar ata; kështu Allahu i ndëshkoi me lloje të ndryshme shkatërrimi dhe dëmtimi. Prandaj, nuk duhet të jemi si ata, e të shkatërrohemi ashtu siç ata u shkatërruan.

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/66517